



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE



## Mbrojtja e të Dhënave Personale

### Udhëzues mbi Përpunimin e të Dhënave Sensitive dhe Marrjen e Autorizimeve

Adresa: “Rr. Kavajës”, Nd. 80, H. 1, Kati 5, 1023, Tiranë

Telefoni: +35542237200

E-mail: [info@idp.al](mailto:info@idp.al)

Website: [www.idp.al](http://www.idp.al)

**Tiranë 2016**

Udhëzuesi ofron disa rregulla bazë të cilat do t'i shërbejnë kontrolluesve publik dhe privat në procesin e përpunimit të të dhënave sensitive, për të garantuar zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Udhëzuesi i drejtohet kontrolluesve dhe përpunuesve, në kushtet e përpunimit gjithnjë e në rritje të të dhënave sensitive.

Janë shtuar aktivitetet në shërbimin ndaj qytetarëve në shëndetësi, sistemin gjyqësor, arsim, sigurime, etj, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja dhe të internetit. Është shtuar informacioni i kërkuar, procedurat dhe përpunimi i dokumenteve, me qëllim të realizimit të një shërbimi më të shpejtë, transparent dhe cilësor ndaj qytetarëve (*subjekte të të dhënave personale*).

### **Ky udhëzues bazohet në:**

- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar.
- Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24.10.1995 “*Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave*”.
- Standardet dhe Rregulloret ndërkombëtare të miratuara nga Bashkimi Evropian (BE).

Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “*Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave*”, në nenin 8 të saj përcakton një regjim të veçantë për përpunimin e të dhënave sensitive të cilat kanë lidhje me racën, fenë, etninë, pikëpamjet politike, pjesëmarrjen në sindikata, shëndetin, gjendjen gjyqësore, jetën seksuale, etj.

### **Ç’ kuptojmë me të dhëna sensitive?**

Në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, përcaktohet se “*të dhënat sensitive*” janë të dhëna personale që përmbajnë informacion për individin si më poshtë:

- origjinën e tij racore ose etnike,
- mendimet politike,
- anëtarësimin në sindikata,
- besimin fetar apo filozofik,
- dënimin penal,
- të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Të dhëna sensitive mund të jenë edhe tiparet biologjike unike, të dhënat biometrike, gjurmët e gishtërinjve, imazhe të retinës, karakteristikat gjenetike, etj.

Në nenin 7/2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përcaktohen kërkesat ligjore që duhet të zbatohen nga kontrolluesit dhe përpunuesit për përpunimin e të dhënave sensitive gjatë aktivitetit të tyre.

### **Kur trajtohet si i ligjshëm përpunimi i të dhënave sensitive?**

Përpunimi i të dhënave sensitive është i ligjshëm kur:

- subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin.
- është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër.
- **autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.**
- lidhet me të dhëna që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore.
- të dhënat përpunohen për qëllime historike, shkencore ose statistikore, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.
- të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përpunimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë.
- të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre.
- përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës.

### **Kuptimi i interesit publik**

Megjithëse nuk ka një rend shterues, rrethanat që përcaktojnë interesin publik përfshijnë:

- interesin e sigurisë kombëtare;
- integritetin territorial ose sigurinë publike;
- parandalimin e trazirave apo krimit;
- parandalimet publike nga të qenit i mashtruar nga një veprim apo deklaratë e një individi;
- mbrojtjen e shëndetit ose moralit;
- mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve;
- parandalimin e zbulimit të informacioneve konfidenciale, ose për të garantuar paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, etj.

**Si duhet realizuar përpunimi i të dhënave sensitive për arsye të një interesi të rëndësishëm publik!**

**Me Autorizim të autoritetit përgjegjës/Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**



Të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizik apo juridik, mund të kufizohen në pajtim me ligjin dhe në masën që është e domosdoshme për të realizuar një interes publik të rëndësishëm.

Përpunimi i të dhënave sensitive për arsye të një interesi të rëndësishëm publik, vlerësohet nga autoriteti përgjegjës i kontrolluesit, duke zbatuar masa të shtuara për mbrojtjen dhe sigurinë e përpunimit të të dhënave sensitive.

Kontrolluesit publik dhe privat në ushtrim të veprimtarisë së tyre, vendosin vetë kur është i nevojshëm përpunimi i të dhënave sensitive për një interes të rëndësishëm publik. Kontrolluesit duhet të vendosin një balancim të drejtë mes interesave publike dhe lirive ose interesave të personave fizik apo juridik, në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e tyre. Në përpunimin e të dhënave personale në zbatim të interesit publik, kontrolluesit dhe përpunuesit publik dhe privat duhet të përpunojnë të dhënat sensitive gjithmonë në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen.

### **Autorizimi**

Kontrolluesit përpara fillimit të përpunimit të të dhënave sensitive për qëllim të interesit të rëndësishëm publik, në kërkesën për Autorizim që paraqesin përpara Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duhet të japin informacion të plotë lidhur me:

- të dhënat e kontrolluesit, (objektin e punës së tij, të dhëna mbi vendodhjen, të dhëna për titullarin, etj).
- qëllimin apo qëllimet e përpunimit të të dhënave personale sensitive.
- kategoritë e subjekteve të të dhënave personale të cilëve u përpunohen të dhënat sensitive.
- marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave sensitive.
- mjetet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave sensitive.
- personat apo subjektet që do të kenë akses në të dhënat sensitive.
- informimin e subjekteve të të dhënave për përpunimin e të dhënave të tyre sensitive.
- informacion për masat e marra për përpunim të sigurtë të të dhënave personale dhe në veçanti për masat shtesë të sigurisë për përpunimin e të dhënave sensitive.

Komisioneri pas shqyrtimit të kërkesës së kontrolluesit vendos nëse mund të kryhet përpunimi i të dhënave sensitive nga kontrolluesi. Në marrjen e vendimit të tij, Komisioneri rast pas rasti përcakton nëse jemi në kushtet që përpunimi i të dhënave sensitive është i nevojshëm për kryerjen e një detyre me interes publik, lidhet me ushtrimin e detyrave publike nga kontrolluesit, ose nga të tretë tek të cilët përhapen të dhënat.

### **Rastet praktike ju vijnë në ndihmë!**

#### **Shembuj të përpunimit të ligjshëm të të dhënave sensitive për një interes të rëndësishëm publik**

##### **Shembull 1**

Ofruesit e shërbimeve shëndetësore të caktuar për trajnimin e stafit mjekësor, gjatë këtij aktiviteti mund të ekspozojnë raste konkrete mbi trajtimin mjekësor të pacientit duke e ndërthurur veprimin ose veprimet me përpunimin e të dhënave personale.

**Gjatë trajtimit** mjekësor përveç pacientit, mjekut dhe stafit mjekësor që kryen trajtimin, prania e të tjerëve kërkon domosdoshmërisht pëlqimin e pacientit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në rast të **trajnitimit** të stafit mjekësor pjesëmarrja e të tjerëve kërkon autorizim të autoritetit përgjegjës/Komisionerit. Kjo, për arsye të ekspozimit të rasteve konkrete të sëmundjeve, prezantimit të fotove, identifikimit të diagnozave, mënyrës së kurimit, etj. Fakti që mund të bëhen publike të dhëna, thënë ndryshe mund të ketë përhapje të të dhënave që ndikojnë ose prekin shoqërinë apo synojnë ndërgjegjësimin e saj në sektorin shëndetësor, provon rëndësinë e interesit të rëndësishëm publik dhe për pasojë autorizimi me masa të përshtatshme mbrojtje është akti që ligjëron përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave.

Ndërsa për regjistrimin e imazheve, regjistrimet video ose audio nga ofruesit e shërbimit shëndetësor që janë caktuar për trajnimin e stafit mjekësor, pëlqimi i pacientit nuk është i nevojshëm nëse lejohet nga autoriteti përgjegjës për interes të rëndësishëm publik nën masa të përshtatshme mbrojtje.

##### **Shembull 2**

Jepet Autorizim për përpunimin e të dhënave gjyqësore nga një kontrollues që kryen shërbim për një interes të rëndësishëm për publikun.

**X** është një kontrollues privat i cili i është drejtuar autoritetit Italian të mbrojtjes së të dhënave personale (Garante), me kërkesë për pajisjen me autorizim për përpunimin e të dhënave gjyqësore, për punonjësit ose të kandidatëve për punë pranë tij, personelit që punon në bazë të kontratave si dhe të të tretëve që punojnë për llogari të kontrolluesit, me të cilët **X** ka të nënshkruara kontrata në fushën e shërbimeve postale.

Kërkesa është shoqëruar me një relacion ku shpjegohen hollësisht masat që do të marrë kontrolluesi për përpunimin e sigurtë të këtyre të dhënave, në zbatim të kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe veçanërisht të dhënave sensitive (ku bëjnë pjesë edhe të dhënat gjyqësore).

Pas shqyrtimit të kërkesës, Garante duke konsideruar se furnizimi dhe shërbimet e lidhura me mbledhjen, administrimin, transportin dhe shpërndarjen e objekteve postale, si dhe operimi me rrjetin publik të postave përbën interes të rëndësishëm publik, ka vendosur:

*Autorizimin e kontrolluesit X për përpunimin e të dhënave gjyqësore, duke i përdorur për qëllimet e deklaruara në kërkesën për pajisje me autorizim, për subjektet e përcaktuara në kërkesën për autorizim, duke respektuar normativat në fuqi për përpunimin e të dhënave sensitive.*

### **Shembull 3**

Rast tjetër është përdorimi i sistemit të kartelave klinike elektronike, i cili në shumë shtete të Evropës është parashikuar në ligje të veçanta. Në saj të këtij sistemi të dhënat shëndetësore të mbledhura nga kontrollues që i japin shërbimin pacienteve, vihen në dispozicion të kontrolluesve të tjerë të cilët merren me shërbim më të gjerë të pacientit, zakonisht në nivel kombëtar.

Grupi i punës i nenit 29 ka konkluduar se ndërtimi i këtyre sistemeve nuk mund të kryhet në bazë të normave ligjore të zakonshme të cilat lidhen me përpunimin e të dhënave personale sipas parashikimit të nenit 8/3 të Direktivës (vo: neni 7/2/dh i ligjit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale), pasi ekzistenca e sistemeve të tilla të kartelave elektronike përbën interes të rëndësishëm publik. Kjo mund të bazohet në nenin 8/4 të Direktivës (neni 7/2/c i ligjit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale) i cila kërkon një bazë juridike specifike për krijimin e tyre dhe përmban edhe garancitë e nevojshme për një përdorim të sigurtë të sistemit.

*Konkluzioni është se këto të dhëna nuk mund të përpunohen pa marrjen e autorizimit nga autoriteti i mbrojtjes së të dhënave personale (Komisioneri).*

### **Shembull 4**

Kontrolluesit nuk duhet që me pretekstin e përpunimit të të dhënave sensitive për një interes të rëndësishëm publik, të shkelin të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave personale. Në shembullin e mëposhtëm tregohet një rast i paligjshëm i përpunimit të të dhënave sensitive, i cili është shqyrtuar nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (CJEU).

#### **Rasti: Huber kundër Shtetit Gjerman**

Zoti Huber qytetar austriak rezident në Gjermani, ka kërkuar nga Zyra Federale për Emigracionin dhe Refugjatët, të fshij të dhënat personale të tij nga regjistri qendror i të huajve (AZR). Ky regjistër përmban të dhënat personale të qytetarëve të Bashkimit Evropian (BE) që nuk kanë shtetësinë gjermane, të cilët qëndrojnë në Gjermani mbi 3 muaj dhe përdoret për qëllime statistikore, si dhe nga forcat e rendit dhe autoritetet gjyqësore gjatë kryerjes së hetimeve dhe operacioneve të lidhura me aktivitetet kriminale ose cënimin e sigurisë publike.

Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka shtruar pyetjen nëse përpunimi i të dhënave personale të përfshira në regjistrin qendror të të huajve (AZR), në të cilin edhe autoritete të tjera publike kanë akses, është në përputhje me të drejtën evropiane, nga momenti që nuk ekziston një regjistër i njëjtë për qytetarët gjerman.

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (CJEU) konsideron së pari që, sipas nenit 7/e të Direktivës, trajtimi i të dhënave personale mund të jetë i ligjshëm vetëm nëse është e nevojshme për kryerjen e një detyre me interes publik ose e lidhur me ushtrimin e detyrës publike. Sipas gjykatës “duke konsideruar qëllimin për të garantuar një nivel të njëjtë mbrojtje në të gjitha vendet anëtare, kuptimi i nevojës për interes publik sipas nenit 7/e të Direktivës 95/46 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit/24 tetor 1995, nuk mund të jetë i ndryshëm në funksion të shteteve anëtare. Kemi të bëjmë me një koncept të pavarur të të drejtës komunitare (evropiane) e cila duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që t’i përgjigjet plotësisht qëllimeve të kësaj direktive.

Gjykata vlerëson se e drejta e lëvizjes së lirë të një qytetari të BE-së në territorin e një shteti anëtar, duke mos qenë shtetas i tij nuk është e kushtëzuar, por i nënshtrohet kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara nga Traktati ose dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj nëse si parim është i ligjshëm që një shtet anëtar disponon një regjistër qendror si AZR si një ndihmë për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për qëndrimin, një regjistër i tillë nuk duhet të përmbajë informacione të tjera që nuk janë të nevojshme për këtë qëllim.

Ndryshe, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale në një regjistër si AZR për qëllime statistikore nuk kanë asnjë bazë të konsiderohen të nevojshme në kuptim të nenit 7/e të Direktivës 95/46/CE. Së fundi për sa i përket luftës kundër kriminalitetit, gjykata vlerëson se ky objektivi lidhet “*ngushtësisht me luftën kundër krimeve, pavarësisht shtetësisë së autorëve të tyre*”.

Ky regjistër nuk përmban të dhëna personale të shtetasve të tij (gjerman) dhe kjo diferencë në trajtim përbën diskriminim, i cili është i ndaluar sipas nenit 18 të Traktatit të funksionimit të Bashkimit Evropian (TFUE). Për pasojë kjo dispozitë, siç interpretohet nga gjykata “*ndalon zbatimin nga një shtet anëtar, për qëllime të luftës kundër krimin të një sistemi për përpunimin e të dhënave personale të veçanta për qytetarët e Bashkimit të cilët nuk janë shtetas të atij shteti anëtar*”.

### **Konsiderata të përgjithshme**

Për çdo përpunim të të dhënave, mjaftueshmëria e tyre është parësore. Pa të dhëna të plota qëllimi i përpunimit nuk mund të realizohet. Përmbushja e qëllimit është përmbushje e detyrimit ligjor të një kontrolluesi në veprimtarinë e punës së tij. Nga ana tjetër çdo veprim në tejkallim të qëllimit për të cilin të dhënat janë mbledhur, (nënkupton tejkallim të përmbushjes së detyrimit ligjor) dhe që vlerësohet i domosdoshëm për të bërë publik një informacion që do të identifikojë të dhënat sensitive, që do të ndikojë në shoqëri apo në një sektor të caktuar, *Lejohet me Autorizim të Komisionerit* duke saktësuar edhe masa shtesë të mbrojtjes dhe përpunimit të këtyre të dhënave.

## **MASAT E SIGURISË QË DUHEN PËRDORUR**

Kontrolluesi duhet të respektojë të drejtat e subjekteve të të dhënave lidhur me mbrojtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit. Kontrolluesi duhet të jetë i regjistruar në regjistrin e subjekteve kontrolluese të cilët kanë njoftuar Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale në aktivitetin e tyre.

Përpara përpunimit të të dhënave sensitive, kontrolluesi ose përpunuesi duhet të kryejë një vlerësim të ndikimit të operacioneve të përpunimit që janë parashikuar në mbrojtjen e të dhënave personale duke evidentuar se ku këto operacione përpunimi mund të paraqesin rreziqe të veçanta ndaj të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave për shkak të natyrës, shtrirjes ose qëllimit të tyre.

Qëllimi apo qëllimet për përpunimin e të dhënave sensitive duhet të jenë të kuptueshme dhe të bazuara në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Në çdo rast kushti i parë për të quajtur të ligjshëm përpunimin e të dhënave sensitive është që pëlqimi duhet të jetë specifik dhe i shprehur qartë. Për këtë, deklarata e pëlqimit duhet të ketë shprehje të qarta dhe të kuptueshme.

Kontrolluesi duhet të informojë në mënyrë të qartë dhe të saktë subjektin e të dhënave për përpunimin e të dhënave sensitive të tij. Informimi do të realizohet sipas kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (neni18). Subjekti i të dhënave duhet të informohet edhe për mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tij sipas ligjit për të dhënat personale. Palët e interesuara informohen për përpunimin e të dhënave sensitive, masat për sigurinë e të dhënave si dhe bazën ligjore mbi të cilën bëhet përpunimi i të dhënave sensitive.

Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave personale që ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave sensitive, për subjektet e treta që kanë akses në këto të dhëna. Subjekti i të dhënave informohet nëse dokumentacioni që përmban të dhënat sensitive të tij, mund të konsultohet edhe pa pëlqimin e tij, por me autorizim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 7/2/c i ligjit).

Përpunimi i të dhënave sensitive, duhet të kryhet vetëm nga persona të cilët për shkak të detyrës mbledhin, përpunojnë, ruajnë të dhëna sensitive, në fusha të tilla si: shëndetësi, gjyqësor, sigurime, punësim, shoqatat apo organizatat shkencore, agjenci administrative, etj.

Kontrolluesi duhet të caktojë persona përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit gjatë përpunimit të të dhënave sensitive. Këta persona duhet të kenë njohuritë e nevojshme për ushtrimin e detyrës së tyre si dhe të njohin mirë sistemet që përdoren nga kontrolluesi.

Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla të veçanta për të drejtat dhe detyrat e personave të ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për përpunimin e të dhënave sensitive. Në këto rregulla duhet të përcaktohet fusha e veprimtarisë, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si dhe mjetet e metodat e plotësimit të detyrës së tyre. Nënshkrimi i deklaratave të konfidencialitetit nga personat përgjegjës, duhet të jetë kusht i përsëritshëm në çdo rast të përpunimit të të dhënave sensitive.

Kontrolluesi duhet të vlerësojë me kujdes kategorinë e të dhënave sensitive që do të përpunohen duke pasur gjithnjë parasysh parimin e proporcionalitetit. Ai duhet të mbledhë ato të dhëna sensitive të cilat realizojnë plotësisht qëllimin e kontrolluesit për aktivitetin e tij në shërbim të subjekteve të të dhënave.



Kontrolluesi duhet të identifikojë me saktësi dhe transparencë subjektet që kanë akses në të dhënat sensitive. Aksesit lejohe vetëm për qëllimin apo qëllimet e lejuara për përpunimin e të dhënave sensitive.

Kontrolluesi duhet të përdorë mënyra dhe mjete që aksesit në të dhënat sensitive të jetë vetëm për persona të domosdoshëm, duke mos lejuar aksesit për subjekte të treta për të cilët aksesit nuk është i nevojshëm. Aksesit duhet të ushtrohet duke përshtatur kategorinë e të dhënave sensitive që përpunohen me detyrat specifike të personit që ka akses.

Për punonjësit e administratës, kontrolluesi duhet të lejojë aksesit vetëm për marrjen e informacioneve të nevojshme për qëllimet administrative të lidhura ngushtë me shërbimin që afrohet kontrolluesi për subjektet e të dhënave (*rezervimet e vizitave, datat e seancave gjyqësore, konkurse të ndryshme, etj.*)

Nisur nga rëndësia e përpunimit të të dhënave sensitive, kontrolluesi duhet të përdorë masa mbrojtëse shtesë për rritjen e sigurisë gjatë përpunimit të tyre, ndryshe nga masat e zakonshme që merren në përgjithësi gjatë përpunimit të të dhënave personale.

Masat që duhet të merren për përpunimin (mbledhja, regjistrimi, ruajtja, etj) e të dhënave sensitive duhet të jenë në gjendje të mbrojnë të dhënat nga rreziqet e mundshme, akseset abuzive, humbjet, dëmtimet, etj. Masat shtesë kanë të bëjnë me:

- Sisteme të identifikimit dhe pajisjes me leje për personat që janë të ngarkuar të kryejnë shërbimet në të cilat përpunohet të dhëna sensitive.
- Përcaktimin e metodave për të realizuar trajtimin dhe ndarjen e të dhënave sensitive nga të dhënat e tjera personale.
- Sisteme ku të evidentohen aksesit dhe përpunimet e të dhënave sensitive.
- Sisteme të auditit për të kontrolluar aksesin në database dhe evidentimin e anomalive të mundshme.
- Sisteme komunikimi të sigurt të bazuara në përdorimin e komunikimeve të anonimizuara midis personave përgjegjës të cilët janë në kontakt dhe realizojnë përpunimin e të dhënave sensitive.

Siguria e të dhënave sensitive nuk realizohet vetëm me vendosjen e mjeteve të duhura, hardware e software, por kërkon edhe marrjen e masave organizative të cilat duhet të përfshijnë:

- trajnimin periodik të të gjithë personelit për rregullat dhe standardet mbi sigurinë e të dhënave sensitive dhe detyrat e tyre, bazuar në kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, veçanërisht përsa i përket ruajtjes së konfidencialitetit.
- shpërndarjen e përgjegjësisë dhe përcaktimin e detajuar të kompetencave në drejtim të përpunimit të të dhënave sensitive, në veçanti në procesin e vendimmarrjes për përpunimin e të dhënave sensitive dhe transferimin e tyre tek të tretët.
- përdorimi i të dhënave personale vetëm në pajtim me udhëzimet e dhëna nga personat drejtues dhe dispozitat ligjore për përpunimin e të dhënave personale.
- mbrojtjen e aksesit në hardware e software të drejtuesve të kontrolluesit, personave që kryejnë përpunimin e të dhënave sensitive si dhe personat që janë të autorizuar që të kenë akses në këto të dhëna.

- masa që autorizimet për akses në të dhënat sensitive të lëshohen nga personat përgjegjës pas kërkesës me shkrim të subjektit që autorizohet.
- përdorimi i mjeteve elektronike për kontrollin e rregullshmërisë për aksesin në të dhënat sensitive dhe rregulla të hollësishme për kontrollin e tyre nga personi i caktuar i mbrojtjes së të dhënave personale.
- Përcaktimi i procedurave shtesë, specifike për trajtimin e dokumenteve shkresore me qëllim parandalimin e aksesit nga persona të paautorizuar në të dhënat personale që përmbajnë këto dokumente, gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre.

Ky Udhëzues përmban një qëndrim të përgjithshëm në lidhje me përpunimin e të dhënave sensitive dhe procedurat që duhet të ndiqen nga kontrolluesit përpara fillimit të përpunimit të tyre.

## ANEKS 1

**Model i kërkesës që i drejtohet Komisionerit për pajisjen me autorizim për përpunim të të dhënave sensitive për një interes të rëndësishëm publik.**

### **K Ë R K E S Ë**

**Objekti:** Kërkohet pajisja me autorizim për përpunimin e të dhënave sensitive

**Drejtuar:** Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Të dhëna për kontrolluesin:

Emri:

selia e tij qendrore:

adresa:

emri i përfaqësuesit:

adresa e përfaqësuesit:

2. Qëllimi ose qëllimet e përpunimit

---

---

---

---

3. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave sensitive

---

---

---

4. Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen

---

---

---

---

5. Personat ose subjektet e treta tek të cilët përhapen të dhënat sensitive

---

---

---

---

6. Afati kohor për ruajtjen e të dhënave sensitive

---

---

---

---

7. Transferimi i të dhënave personale në shtete të tjera

---

---

---

---

8. Deklarimi i masave shtesë teknike dhe organizative për mbrojtjen dhe sigurinë gjatë  
përpunimit të të dhënave sensitive

---

---

---

---

**KONTROLLUESI**